



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T
të mbledhjes së katër të Komitetit për Politikë dhe Financa,
mbajtur më 17.06.2014, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Halim Halimi, kryesues, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Islam Pacolli dhe Cuneyd Ustaibo.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, përfaqësuesi i INPO-së dhe përfaqësuesi i OSBE –së.

Munguan: Imer Rusinovci dhe Sami Hamiti.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik – Prishtina e Re;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për objekt sporti – Rekreacioni ujor publik i tipit të mbyllur;
4. Propozimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes “Kalabria”;
5. Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ;
6. Propozimrregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike;
7. Propozimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale;
8. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për zgjedhjen e Këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
9. Raporti i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Prishtinës;
10. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Agim Salihu** tha se në Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Urbanizmit, u propozua edhe një pikë shtesë e rendit të ditës: Propozimi për miratimin e vendimit për lidhjen e rrethrotullimit të "Termokosi" me rrugën paralele Prishtinë - Shkup, në kuadër të Planit rregullues të lagjes "Kalabria" në Prishtinë. Kjo pikë ka kaluar në këtë komitet, me propozim që të dërgohet më tutje për miratim, andaj kërkoj që të futet në diskutim në pikën "Të ndryshme".

Njëherësh informoi se në Rregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, ka ndryshime dhe sugjerime nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, andaj edhe kjo të diskutohet në "Të ndryshme".

Kryesuesi tha se, pasi që nuk ka qenë pikë e rendit të ditës në Këshillin e Drejtorëve, s'mundet të jetë pikë e rendit të ditës në Komitetin për Politik dhe Financa.

Dardan Sejdiu propozoi që kjo pikë e propozuar të mbetet për mbledhjen e radhës.

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpiq - Prishtina e Re, **Agim Salihu** theksoi se është fjala për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpiq, në të cilën do të vendosen Komiteti Olimpik i Kosovës, Komiteti Paraolimpik i Kosovës, si dhe 35 federata të sporteve.

Ky lokacion është propozuar të jetë në lagjen "Prishtina e Re", ku tani gjenden edhe objektet e Pallatit të drejtësisë dhe për këtë destinim është kërkuar parcelë ndërtimore me një sipërfaqe prej 2400 m².

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpiq - Prishtina e Re, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për objekt sporti - Rekreacioni uxor publik i tipit të mbyllur, informoi **Agim Salihu**, duke shtuar se është fjala për caktimin e një lokacioni për ndërtimin e objektit të sportit dhe rekreacionit uxor publik të tipit të mbyllur, të cilin deri tani qyteti i Prishtinës nuk e ka pasur, andaj për këtë qëllim është propozuar lokacioni në lagjen "Arbëria 3".

Ai kërkoj që për mbledhje të Kuvendit të kompletohet materiali, t'i bashkëngjiten kopja e planit, certifikata kadastrale dhe foto.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për objekt sporti - Rekreacioni uxor publik i tipit të mbyllur, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimin për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes "Kalabria" informoi **Agim Salihu**. Ai tha se është fjala për disa lëvizje të vogla të rrugëve për shkak të ndryshimeve në terren të lagjes "Kalabria", prandaj duhet të bëhen disa ndryshime në infrastrukturën rrugore të kësaj lagjeje. Një herësh ceku se kjo nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh, mirëpo duhet nga Kuvendi të jepet një pëlqim.

Dardan Sejdiu theksoi se është një ndryshim, një lëvizje e vogël e trasesë së rrugës ndërmjet bllokut „B 4” dhe „B 6” dhe lidhja e saj me rrugën mbi lumin Prishtina.

Hazir Borovci përkrahu dërgimin e këtij propozimvendimi më tutje, pasi që ka kaluar në Këshillin e Drejtorëve dhe në Komitetin për Urbanizëm.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes "Kalabria", dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimrregulloren për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, **Agim Salihu** tha se kjo pikë ka kaluar në Komitetin e Shërbimeve Publike. Çështje kryesore në këtë takim ka qenë çështja e tarifave, si lirimi nga kryerja e shërbimit për varrim, si dhe rëndësia e objektit komemorativ, i cili tash për tash nuk është duke u përdorur. Po ashtu u propozua që të caktohet koha për pritje të kufomës në atë objekt komemorativ deri në kohën e varrimit, dhe për kohë të shkurtër të jetë pa pagesë, ndërsa qëndrimi në kohë më të gjatë të jetë me pagesë.

Ylli Hoxha pyeti se pse nuk po përdoret objekti komemorativ.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me këtë çështje, duke cekur se do të rregullohet ky objekt dhe do t'i jepet në menaxhim Ndërmarrjes Publike „Hortikultura” edhe pse Bashkësia Islame e ka kërkuar për shfrytëzim.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimrregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, **Halim Halimi** tha se kjo rregullore ka qenë edhe në mandatin e kaluar, ku dhe ka kaluar në Këshillin e Drejtorëve dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe më pas ka shkuar në Kuvend, por për atë që është kërkuar në Kuvend, nuk është bërë.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me këtë rregullore, duke thënë se po flitet për një rregullore të sistemuar më ndryshme. Në nenin 4, kemi të gjitha llojet e objekteve të përkohshme. Me këtë rregullore rregullohet dhënia në shfrytëzim e pronës publike në udhëheqje dhe administrim të Komunës. Kemi mbikëqyrjen e kësaj rregulloreje, dispozitat ndëshkimore, dispozitat kalimtare dhe të hyrjes në fuqi.

Hazir Borovci propozoi që kjo rregullore të procedohet më tutje.

Dardan Sejdiu theksoi se kjo rregullore duhet të dërgohet në Kuvend që të diskutohet atje.

Ylli Hoxha tha se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e specifikon këtë rregullore, andaj është mirë që të na sillet një dokument që konfirmon se është vendim ligjor, gjegjësisht që nuk është në kundërshtim me ligjin.

Agim Salihu tha se kjo rregullore është në harmoni me ligjin dhe ka kaluar në Këshillin e Drejtorëve dhe në Komitetin për Shërbime Publike. Me këtë rregullore po mbrohen sipërfaqet publike.

Islam Pacolli u interesua se çfarë afati kohor parashihet për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe a parashihet ndërtim i fortë.

Agim Salihu tha se afati kohor është 5 vjet, ku për çdo vit duhet të kërkohet leje. Sa i përket ndërtimit, duhet të jetë ndërtim i lehtë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, me sugjerim që të kontaktohet me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimin për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, arsyetimin për ndryshimin e rregullores e dha Agim Salihu. Ai tha se ka qenë propozim i drejtorit të Drejtorisë së Administratës, që të lirohen nga pagesa e taksave të Zyrës së ofiqarisë edhe tri kategori të personave që nuk kanë qenë të përfshirë deri tani.

Në Komitetin për Shërbime Publike është kërkuar që shfrytëzimi i hapësirave publike për vendosjen e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm me reklama, të lirohen nga pagesa.

Dardan Sejdiu tha se janë marrë parasysh çmimet nga rajoni, janë vendosur çmimet siç janë qytetet Shkupi, Podgorica etj.

Islam Pacolli pyeti se te lirimi nga pagesa e taksave te familjarët e dëshmorëve, kush përfshihet në rrethin e familjarëve.

Agim Salihu tha se në rrethin e ngushtë familjar janë paraparë të përfshihen bashkëshortët dhe fëmijët.

Hazir Borovci tha se ky lirim i kategorive të personave nga pagesa e taksave, është i qëlluar dhe e përkrahim. Ai tha se do të ishte mirë që të ulen këto tarifa mujore: te neni 2, paragrafi 6.9, te sezoni veror, zona I, nga 6 €/m² në 5 €/m², në zonën II, nga 4.5 €/m² në 3.5 €/m², po ashtu edhe te sezoni i dimëror, te zona I të ulet tarifa.

Te neni 2, paragrafi 6.11, tarifa vjetore për tendë prej 50 €/m², konsiderojmë se këto tarifa janë të larta, andaj a ka mundësi që këto të ulën?

Dardan Sejdiu tha se në rregulloren ekzistuese tarifa te zona I ka qenë 8 €/m², e kemi ulur në 6 €/m² dhe i kemi mundësuar me punuar edhe në sezonin e dimrit.

Nuk jemi për t'i ngarkuar me tarifa. Këto çmime që janë tani, janë çmime që aplikohen në rajon, si në Shkup, Tiranë etj. dhe të shohim për vitin tjetër nëse kemi mundësi me i liruar këto tarifa.

Hazir Borovci u shpreh i pajtimit për ulje të tarifës prej 8 €/m² në 6 €/m².

Ylli Hoxha theksoi se e përkrahim këtë rregullore që të procedohet më tutje.

Edhe **Islam Pacolli** u pajtua që kjo rregullore të shkojë më tutje.

Cyneyd Ustaibo tha se a ka mundësi të lirohen ato biznese që paguajnë paraprakisht për 6 muaj tarifaf.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me çështjen e parashtruar nga Cyneyd Ustaibo.

Cyneyd Ustaibo e përkrahu dërgimin e kësaj rregulloreje më tutje.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimin për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, Agim Salihu tha se është fjala për një kryetar të Bashkësisë lokale të lagjes "Lakërishtë", i cili ka vdekur dhe duhet të emërohet kryetari i ri.

Në Këshillin e Drejtorëve është propozuar të jetë një vendim për caktimin e komisionit për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Sa i përket emrave të anëtarëve të komisionit, mbetet që në Kuvend të propozohen nga subjektet politike.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e komisionit për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Pika e nëntë

Lidhur me Raportin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Prishtinës, Dardan Sejdiu theksoi se duhet të shikohet se a është materiali i gatshëm që të shqyrtohet në Kuvend.

Të ndryshme

Agim Salihu tha se në Rregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, duhet të bëhen disa ndryshime edhe të disa dispozitave të tjera të kësaj rregulloreje bazë dhe sipas sugjerimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për largim të nenit 7.2. Ky propozim i dërgohet Kuvendit për miratim.

Islam Pacolli tha se anëtarët e komisionit për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, janë të brendashëm, apo mund të jenë edhe të jashtëm.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtës :
Zijadin Gashi
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur.i dipl.